



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:247688

Datë: 08.11.2023

Numri i dokumentit: 04890253

C.nr.2462/2015

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS – Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, duke shqyrtuar dhe zgjidhur kontestin nga marrëdhënia juridike civile sipas padisë së paditësve M. S., J. S., A. S. dhe F. S., që të gjithë nga fshati S. e M., Komuna e Fushë Kosovës, përfaqësuar me autorizim nga J. I., avokat në Prishtinë, kundër të paditurës Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari”, me seli në Prishtinë, me objekt të kontestit shpërblimin e dëmit në formën e fitimit të humbur, me vlerë të objektit të kontestit në shumën prej 59,594.26€ (pesëdhjetenëntëmijepesëqindënëntëdhjetekatër euro e njëzetegjashtë euro/cent), pas përfundimit të shqyrtimit kryesor të çështjes të mbajtur më 20.09.2023, në seancë publike, në të cilën ka prezantuar i autorizuari i paditësve dhe në mungesë të së paditurës, të njëjtën datë dha këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET NË TËRËSI SI E THEMELET kërkesëpadia e paditësve M. S., J. S., A. S. dhe F. S., që të gjithë nga fshati S. e M., Komuna e Fushë Kosovës dhe DETYROHET e paditura Aeroporti Ndërkombëtar “Adem Jashari”, me seli në Prishtinë, që paditësve në emër të kompensimit të dëmit për fitimin e munguar dhe atë për parcelën nr. ... dhe ..., me kulturë arë e klasës III, që gjenden në vendin e quajtur “...”, ZK Sllatinë e Madhe, Fushë Kosovë, për periudhën prej 01.06.2004 deri 01.04.2015, dhe atë paditësit M. S. për sipërfaqen prej 0.34,00 ha, shumën prej 13,729.54€, paditësit J. S. për sipërfaqen prej 0.37.86 ha, shumën prej 15,288.24€, paditësit A. S. për sipërfaqen prej 0.37.86 ha, shumën prej 15,288.24€ dhe për paditësin F. S. për sipërfaqen prej 0.37.86

ha, shumën prej 15,288.24€, me kamatë vjetore sipas shkallës së kamatës që paguajnë bankat për mjete të deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke filluar prej datës 19.10.2015 e deri te pagesa definitive, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi.

II. DETYROHET e paditura që paditësve në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore t'ua paguaj shumën prej 2,792.00€, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të aktgjykimit.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre, në këtë gjykatë kanë parashtruar padi, kundër të paditurës, me objekt të kontestit dhe vlerë të objektit të kontestit si në hyrje të këtij aktgjykimi, duke kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve në emër të kompensimit të dëmit për fitimin e munguar dhe atë për parcelën nr. ... dhe ..., me kulturë arë e klasës III, që gjenden në vendin e quajtur "...", zk s. e m., fushë kosovë, për periudhën prej 01.06.2004 deri 01.04.2015, dhe atë paditësit M. S. për sipërfaqen prej 0.34,00 ha, shumën prej 13,729.54€, paditësit J. S. për sipërfaqen prej 0.37.86 ha, shumën prej 15,288.24€, paditësit A. S. për sipërfaqen prej 0.37.86 ha, shumën prej 15,288.24€ dhe për paditësin F. S. për sipërfaqen prej 0.37.86 ha, shumën prej 15,288.24€, me kamatë vjetore prej 7% duke filluar prej datës 19.10.2015 e deri te pagesa definitive, në afat prej 15 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi.

I autorizuari i paditësve, në seancat e mbajtura dhe në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ka deklaruar se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar nga fakti se të njëjtit nga 01.06.2004, nuk kanë mundur të shfrytëzojnë paluajtshmëritë e tyre sepse të njëjtat janë ekspropriuar dhe se të njëjtëve nuk iu është paguar kompensimi edhe pse ngastrat e tyre ishin ekspropriuar ku edhe pas caktimit të kompensimit për pasurinë e ekspropriuar e paditura kishte theksuar se nuk e kundërshton propozimin e propozuesve

dhe as vlerën e caktuar, mirëpo në mungesë të mjeteve financiare nuk kanë mundësi të përmbushin detyrimin. Tutje ka shtuar se fitimi që ka mundur të realizohej nga rendimentet bujqësore nga data 01.06.2004 e deri më 01.04.2015 është vërtetuar saktë në bazë të raportit për vlerësimin e fitimit të humbur të punuar nga eksperti i bujqësisë . përgjegjësia e të paditura për pagimin e fitimit të humbur është sepse e njëjta është shfrytëzuese e paluajtshmërive të ekspropriuar. Nga këto të cekura i ka propozuar gjykatës aprovimin e padisë dhe kërkesës së saj.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për padi shumën prej 520.00€, për përpilimin e parashtresës për precizimin e padisë shumën prej 520.00€, për taksë gjyqësore shumën prej 100.00€, për ekspertizë shumën prej 300.00€, për dy seanca shumën prej 1,352.00€, gjithsejtë shumën prej 2,792.00€.

E paditua me përgjigje në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditësve, duke shtuar se me asnjë provë nuk është vërtetuar pretendimi i tyre për fitimi në humbur.

E paditura për seancat e mbajtura ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt, në seanca nuk ka prezantuar askush, andaj gjykata seancën përgatitore dhe seancën e shqyrtimit kryesor e ka mbjatur në mungesë së të paditurës të ftuar në mënyrë të rregullt.

Gjendja faktike e vërtetuar

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen kontestuese, gjykata në procedurën e provave, në shqyrtimin kryesor - publik të dt. 20.09.2023, sipas propozimit të palëve ka administruar provat e propozuara, dhe atë: aktvendimin N.nr.195/2005, të datës 13.10.2023, të kësaj gjykate, aktvendimin CA.nr.3889/2013, të datës 16.05.2015, të Gjykatës së Apelit të Kosovës, vendimin 06 nr. 58 i datës 01.06.2004, i Komunës së Fushë Kosovës dhe ekspertiza bujqësore.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovon në tërësi si të themeltë në prova dhe ligj.

Nga provat që janë administruara gjykata gjeti se për qëllime të zgjerimit të sipërfaqes dhe perimetrit të së paditurës janë eksproprijuar ndër të tjera edhe sipërfaqja prej 01.14.10 ha, paraardhësit të paditësve.

Paditësit, të pakënaqur me shumën e ofruar nga shfrytëzuesi i pasurisë së eksproprijuar, këtu e paditura, kanë parashtruar propozim për caktimin e lartësisë së pronës së shpronësuar. Duke vendosur sipas këtij propozimi kjo gjykatë me aktvendimin N.nr.195/2005, ka detyruar këtu të paditurën që paditësve t’ua paguaj më gjerësisht si në atë aktvendim. Ai aktvendim është vërtetuar nga Gjykata e Apelit e Kosovës me aktvendimin CA.nr.2889/2013, të datës 16.05.2014.

Baza ligjore

Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoj, në çoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij ”, neni 158 përcakton se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia ”.

Me nenin 185 paragraf 1, përcaktohet se: “Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendos gjendjen e ekzistuar para se të shkaktohej dëmi”, ndërsa me paragrafin 2, të po këtij neni, përcaktohet se: “Në qoftë se rivendosja e gjendjes së mëparshme nuk e mënjanon plotësisht dëmin, personi përgjegjës ka për detyrë që për pjesën tjetër të dëmit të jap kompensim në të holla”.

Me nenin 189 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “ I dëmtuari ka të drejtë si për kompensimin e dëmit të thjeshtë, ashtu edhe për kompensimin e fitimit të munguar”,

ndërsa në paragrafin 3, të po këtij neni, përcaktohet se: “ Gjatë vlerësimit të shumës së përfitimit të munguar merret në konsiderim fitimi që ka mundur të pritej në mënyrë të bazuar sipas procesit të rregullt të sendeve ose sipas rrethanave të veçanta, ndërsa realizimi i të cilave është penguar nga veprimi i dëmtuesit ose nga ometimi ”.

Vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore dhe nga gjendja faktike e vërtetuar si më lart, kjo gjykatë erdhi në përfundim se paditura ka për detyrim që paditësve t’ua kompensoj dëmin e shkaktuar në paluajtshmërinë kontestuese dhe fitimin e humbur për shkak të pamundësisë për të punuar tokën e tyre, në shumën e gjykuar si në dispozitiv të aktgjykimit, për arsyeje se e paditura me asnjë provë të vetme nuk e ka argumentuar faktin se nuk i ka shkaktuar dëm paditësve në paluajtshmërinë e tyre kontestuese.

Gjykata ka vlerësuar edhe provat tjera materiale të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk janë relevante dhe janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike.

Vendimi sa i përket kamatës është në pajtim me nenin 277 të LMD-së.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi në bazë të nenit 452 par. 1 të LPK. Lartësia e shpenzimeve i referohet shpenzimeve për përpilimin e padisë në shumë prej 520.00 euro, për përpilimin e precizimit të padisë shumë prej 520.00 euro, për dy seancave gjyqësore në shumë prej 1,352.0 euro, ekspertizën në shumë prej 300.00 euro e në shumë të përgjithshme prej 2,792.0 euro.

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2462/2015, datë 20.09.2023.

GJYQTARI

PËRPARIM ZEKA

UDHËZIMI MBI TË DREJTËN E ANKESËS:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të së njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palën kundërshtare.

Kopje e këtij aktgjykimi i dërgohet:

- Av. Jeton Idrizi, dhe
- Aeroportit Ndërkombëtar “Adem Jashari”, Prishtinë.